

## **Modul Trajnimi**

# **Buxheti Bashkiak për të Rinjtë – Si ta Kuptojmë & Ndryshojmë!**

## **Listë Akronimesh**

*BB - Buxheti Bashkiak*

*PB - Procesi i Buxhetimit*

*MF - Ministria e Financave*

*KB - Këshilli Bashkiak*

*PBA - Programi Buxhetor Afatmesëm*

*IPF - Instrumenti i Planifikimit Financiar*

*KP - Konsultimi Publik*

*SMB - Strategjia e Menaxhimit të Buxhetit*

*OJQ - Organizata Joqeveritare*

*KVR - Këshilli Vendor Rinor*

*BPGJ - Buxhetimi i Përgjigjshëm Gjinator*

*IDM – Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim*

*BAT – Transparencë dhe Llogaridhënie Buxhetore*

*H.A.N.A – Qendra “Hand to Hand Against Nation Apathy”*

## **Përmbajtja Kryesore**

### 1 Hyrje në Buxhetimin Bashkiak

#### 1.1 Çfarë është buxheti bashkiak dhe pse ka rëndësi për jetën e të rinjve?

- 1.1.1 Përshkrim i rolit të buxhetit bashkiak si një mjet kryesor për financimin e shërbimeve publike dhe zhvillimin e komunitetit.
- 1.1.2 Diskutim mbi mënyrën sesi buxheti ndikon në arsim, kulturë, hapësira publike dhe mundësi për të rinjtë.
- 1.1.3 Përfshirja e shembujve konkretë nga bashkitë shqiptare për të ilustruar ndikimin.

#### 1.2 Ligjet dhe rregulloret për procesin buxhetor në gjuhë të thjeshtuar

- 1.2.1 Shpjegim i kornizës ligjore që rregullon buxhetimin në Shqipëri, si Ligji për Vetëqeverisjen Vendore dhe Udhëzimi për PBA.
- 1.2.2 Një tabelë me hapa të qartë mbi procesin e buxhetimit, nga draftimi deri te miratimi nga Këshilli Bashkiak.

#### 1.3 Struktura e buxhetit

- 1.3.1 Pjesët kryesore: të ardhurat (tatimet, tarifat, transferimet) dhe shpenzimet (investime dhe shërbime publike).
- 1.3.2 Lidhja e strukturës së buxhetit me prioritetet e komunitetit dhe ndikimi në jetën e përditshme.

### 2 Procesi i Buxhetimit

#### 2.1 Përfshirja e komunitetit dhe të rinjve në vendimmarrje

- 2.1.1 Diskutimi i rëndësisë së përfshirjes së të rinjve në diskutimet publike për të përcaktuar prioritetet e komunitetit.
- 2.1.2 Shembuj të mirëpranuar ndërkombëtarë dhe lokalë mbi përfshirjen e qytetarëve në procesin e buxhetimit.

## **2.2 Rëndësia dhe përfitimet e angazhimit komunitar në vendimmarrjen vendore**

- 2.2.1 Përfitime si transparenca, ndarja më e drejtë e burimeve, dhe ndërtimi i besimit mes qeverisë dhe qytetarëve.
- 2.2.2 Praktika për mbledhjen e mendimeve dhe nevojave të të rinjve.

## **2.3 Procesi i konsultimeve publike në hartimin e buxhetit**

- 2.3.1 Çfarë janë konsultimet publike dhe si zhvillohen (bazuar në përvojën shqiptare dhe legjislacionin aktual).
- 2.3.2 Rëndësia e pjesëmarrjes aktive të të rinjve në këto takime dhe teknikat për t'u përgatitur.

# **3 Interpretimi i Dokumenteve Financiare**

## **3.1 Si të lexohen dhe kuptohen tabelat financiare për buxhetin**

- 3.1.1 Përmbledhje e elementeve kryesore si të ardhurat e përgjithshme, shpenzimet e detajuara dhe balanca financiare.
- 3.1.2 Ushtrime praktike me shembuj realë të dokumenteve buxhetore.

## **3.2 Identifikimi i shpenzimeve prioritare dhe objektivave të politikave**

- 3.2.1 Si të dallohen shpenzimet që ndikojnë drejtpërdrejt në prioritetet e komunitetit.
- 3.2.2 Shembull: përzgjedhja e fondeve për projekte rinore dhe sportive.

# **4 Zhvillimi i Aftësive Praktike**

## **4.1 Ushtrime në interpretimin e dokumenteve të buxhetit**

- 4.1.1 Ushtrime të thjeshta që i ndihmojnë pjesëmarrësit të kuptojnë dhe analizojnë dokumentet financiare.
- 4.1.2 Përfshirja e tabelave dhe grafikëve vizualë për ta bërë më të lehtë procesin.

## **4.2 Rast studimor**

- 4.2.1 Një rast konkret nga një bashki shqiptare ku të rinjtë kanë ndikuar në ndarjen e fondeve për një projekt të veçantë (p.sh., ndërtimi i një këndi për të rinjtë).

## **Hyrje**

Ky dokument është hartuar si pjesë e implementimit të ndërhyrjes "Itinerari i Parasë Publike - Rinia Raporton," e mbështetur nga mekanizmi i financimit BAT (Llogaridhënia dhe Transparenca Buxhetore), implementuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), Qendra për Kërkime dhe Hartim Politikash (CRPM) dhe Faktoje, me financim nga Bashkimi Evropian. Ndërhyrja synon fuqizimin e të rinjve për të marrë pjesë në mënyrë aktive në monitorimin e buxheteve publike dhe për të kontribuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies.

Kjo përpjekje është pjesë e përkushtimit të H.A.N.A.-s për të kontribuar në forcimin e demokracisë dhe përfshirjes së të rinjve në vendimmarrje, ndërsa promovon aktivizmin qytetar. Ne besojmë se angazhimi i të rinjve është kyç për ndërtimin e një shoqërie më transparente, të drejtë dhe të përfshirëse.

Përmes këtij moduli në synojmë të ndihmojmë të rinjtë të kuptojnë rëndësinë e buxheteve publike dhe të ndërgjegjësohen mbi mënyrat se si mund të ndikojnë në procesin e vendimmarrjes; të promovojmë pjesëmarrjen aktive të të rinjve në demokraci, përmes zhvillimit të aftësive dhe njohurive për monitorimin dhe raportimin mbi shpenzimet publike dhe së fundmi të forcojmë aktivizmin qytetar, duke nxitur dialogun dhe ndërveprimin midis të rinjve dhe institucioneve vendore.

Qendra H.A.N.A. është e përkushtuar të shërbejë si një urë lidhëse midis të rinjve dhe institucioneve vendore, duke krijuar mundësi për angazhim dhe pjesëmarrje të informuar në proceset demokratike. Nëpërmjet këtij dokumenti dhe aktiviteteve përkatëse, ne synojmë të fuqizojmë të rinjtë me aftësi praktike, për t'u bërë aktorë të rëndësishëm në përmirësimin e transparencës së buxhetimit lokal, të nxisim vetëdijen qytetare, duke u fokusuar në rëndësinë e monitorimit të fondeve publike dhe rolit të tyre në zhvillimin e komunitetit si dhe të promovojmë praktikën më të mira të përgjegjshmërisë financiare, përmes edukimit dhe bashkëpunimit me palët e interesuara.

Kjo ndërhyrje përputhet me vizionin tonë për një rini më të fuqizuar dhe një shoqëri ku pjesëmarrja qytetare është shtylla kryesore e qeverisjes demokratike.

# 1 Hyrje në Buxhetimin Bashkiak

## 1.1 Çfarë është buxheti bashkiak dhe pse ka rëndësi për jetën e të rinjve?

Buxheti bashkiak është plani financiar i përpiluar nga bashkia për të menaxhuar të ardhurat dhe shpenzimet për nevojat e komunitetit. Ai përfshin gjithçka nga financimi i projekteve publike deri te ofrimi i shërbimeve të domosdoshme si uji, dritat, pastrimi dhe edukimi. Për të rinjtë, kuptimi i buxhetit bashkiak është i rëndësishëm sepse shpenzimet e tij ndihmojnë në krijimin e mundësive të reja dhe përmirësimin e jetës së përditshme. Pjesëmarrja e të rinjve në diskutimet për buxhetin është thelbësore për të siguruar që zëri i tyre të merret parasysh dhe që prioritetet e tyre të reflektohen në vendimmarrje.

1.1.1 Përshkrim i rolit të buxhetit bashkiak si një mjet kryesor për financimin e shërbimeve publike dhe zhvillimin e komunitetit.

Buxheti bashkiak është si plani vjetor i familjes, ku bashkia vendos se si do të përdoren të ardhurat për të përmbushur nevojat e komunitetit. Ai përmban burimet financiare që vijnë nga taksat dhe tarifatat lokale, si dhe nga transfertat nga qeveria qendrore dhe donatorët. Shërbimet publike si pastrimi i qytetit, përmirësimi i infrastrukturës, ndihma sociale dhe investimet në projekte rinore varen nga ky buxhet. Një buxhet i përpiluar mirë siguron që burimet financiare të shfrytëzohen me efikasitet për të përmirësuar jetën e komunitetit dhe për të adresuar sfidat specifike që hasin të rinjtë në përditshmëri.

1.1.2 Diskutim mbi mënyrën sesi buxheti ndikon në arsim, kulturë, hapësira publike dhe mundësi për të rinjtë.

Buxheti bashkiak ndikon drejtpërdrejtë në fusha që janë jetësore për të rinjtë. Për shembull, financimi i shkollave dhe aktiviteteve jashtëshkollore varet nga prioritetet e vendosura në buxhet. Hapësirat publike si këndet e lojërave, bibliotekat dhe parket janë të financuara nga fondet e bashkisë, duke ndihmuar në krijimin e mjediseve që nxisin zhvillimin personal dhe social të të rinjve. Gjithashtu, projektet që mbështesin aktivitetet kulturore, si festivale ose trajnime artistike, sigurojnë

mundësi për angazhim dhe zhvillim të talenteve. Kur buxheti planifikohet me kujdes, ai krijon mundësi që ndikojnë pozitivisht në arsimimin dhe zhvillimin e të rinjve.

### 1.1.3 Përfshirja e shembujve konkretë nga bashkitë shqiptare për të ilustruar ndikimin.

Një shembull i rëndësishëm nga Bashkia e Lezhës është hartimi dhe miratimi i Planit Strategjik Vendor për Rininë 2024-2027. Ky dokument synon të adresojë nevojat dhe prioritetet e të rinjve, duke ofruar një kornizë për aktivitete dhe mundësi zhvillimi. Megjithatë, H.A.N.A ka identifikuar disa mangësi në përmbajtjen e këtij plani dhe ka kërkuar nga bashkia që të reflektojë mbi këto shqetësime. Për fat të keq, kërkesat dhe shqetësimet e ngritura nuk u përfshinë në dokumentin final, duke nënvizuar një mungesë të konsiderueshme të përfshirjes efektive të komunitetit rinor.

Ky rast tregon se, ndonëse bashkia ka bërë një hap të nevojshëm drejt krijimit të një dokumenti strategjik për të rinjtë, procesi mund të jetë rrezikuar nga mungesa e konsultimeve të plota dhe përfshirjes së aktorëve rinorë. Plani Strategjik Vendor për Rininë 2024-2027 mbart një rëndësi të madhe, por mosmiratimi i plotë i reagimeve nga palët e interesuara të rinisë mund të përbëjë një sinjal jo të mirë për transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve vendore.

Për të parandaluar situata të tilla, është thelbësore që bashkitë të mbajnë llogari dhe të marrin seriozisht reagimet e komunitetit. Duhet ushtruar më shumë presion nga qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile për të siguruar që politika dhe strategjitë të reflektojnë realisht nevojat e grupmoshave që ato synojnë të ndihmojnë.

## 1.2 Ligjet dhe rregulloret për procesin buxhetor në gjuhë të thjeshtuar

Procesi i buxhetimit në Shqipëri është i rregulluar nga një kornizë ligjore që siguron funksionimin e duhur të bashkive dhe garanton transparencën në menaxhimin e fondeve publike. Për të rinjtë, kuptimi i këtyre ligjeve dhe rregulloreve është jetik, sepse u mundëson të kuptojnë bazën ligjore mbi të cilën ndërtohen vendimet që ndikojnë komunitetin e tyre. Ligjet dhe rregulloret ndihmojnë të përcaktohen

përgjegjësitë dhe hapat që ndjekin bashkitë për të planifikuar dhe miratuar buxhetet e tyre.

1.2.1 Shpjegim i kornizës ligjore që rregullon buxhetimin në Shqipëri, si Ligji për Vetëqeverisjen Vendore dhe Udhëzimi për PBA.

Në Shqipëri, procesi buxhetor rregullohet nga disa ligje dhe udhëzime kryesore, të cilat bashkitë duhet t'i respektojnë në mënyrë rigoroze. Dy prej dokumenteve më të rëndësishme janë:

- *Ligji për Vetëqeverisjen Vendore (Nr. 139/2015)*: Ky ligj përcakton mënyrën se si funksionojnë bashkitë dhe rolin e tyre për të garantuar shërbimet publike dhe zhvillimin ekonomik e social. Ai gjithashtu përcakton se buxheti i bashkisë duhet të jetë i hapur për konsultime publike përpara se të miratohet nga Këshilli Bashkiak.
- *Udhëzimi për Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA)*: Ky dokument ndihmon bashkitë të planifikojnë dhe menaxhojnë fondet e tyre për një periudhë trevjeçare. Ai siguron që buxhetet të jenë në përputhje me objektivat strategjike të zhvillimit lokal dhe nevojat e komunitetit.

Për t'i bërë më të kuptueshme për të rinjtë, këto ligje mund të përkthehen në hapa praktikë që tregojnë si përfshihen qytetarët në procesin e buxhetimit dhe si mund të ndikojnë ata.

1.2.2 Një tabelë me hapa të qartë mbi procesin e buxhetimit, nga draftimi deri te miratimi nga Këshilli Bashkiak.

Procesi i buxhetimit në një bashki kalon në disa faza kyçe, të cilat janë të përcaktuara me ligj dhe ndjekin një rrjedhë të qartë. Kjo tabelë përmbledh hapat kryesorë të procesit:

<i>Hapi</i>	<i>Përshkrimi</i>
1. Hartimi i Draftit të Buxhetit	Administrata bashkiake harton një draft të buxhetit bazuar në prioritetet lokale dhe burimet financiare të disponueshme.
2. Konsultimet Publike	Organizohen takime me qytetarët dhe aktorët kryesorë për të marrë sugjerime dhe komente mbi draftin e propozuar.
3. Rishikimi nga Këshilli Bashkiak	Këshilli Bashkiak shqyrton draftin dhe propozon ndryshime bazuar në konsultimet publike dhe analizat e nevojave.
4. Miratimi nga Këshilli Bashkiak	Pas diskutimeve dhe rishikimeve, Këshilli Bashkiak voton për miratimin e buxhetit përfundimtar.
5. Monitorimi dhe Raportimi	Zbatimi i buxhetit monitorohet dhe raportet mbi shpenzimet bëhen publike për të garantuar transparencë dhe llogaridhënie.

Kjo strukturë është krijuar për të siguruar që procesi të jetë gjithëpërfshirës dhe transparent. Megjithatë, në shumë raste, konsultimet publike janë formale dhe jo mjaftueshëm efektive për të marrë në konsideratë zërin e të rinjve dhe të grupeve të tjera të interesit.

### 1.3 Struktura e buxhetit

Për të kuptuar se si bashkitë në Shqipëri planifikojnë dhe menaxhojnë financat e tyre, është e rëndësishme të shqyrtojmë strukturën e buxhetit të tyre. Kjo strukturë përbëhet kryesisht nga dy pjesë: të ardhurat dhe shpenzimet.

1.3.1 Pjesët kryesore: të ardhurat (tatimet, tarifat, transferimet) dhe shpenzimet (investime dhe shërbime publike).

Të Ardhurat janë burimet financiare që bashkia mbledh për të financuar shërbimet dhe investimet publike. Të ardhurat kryesore përfshijnë:

- Tatimet dhe Tarifet Vendore që janë taksa dhe tarifa që paguhen nga qytetarët dhe bizneset, si p.sh., taksa mbi pronën, tarifa për shërbime publike, etj.
- Transferimet nga Qeveria Qendrore që janë fonde që qeveria qendrore i transferon bashkive për të mbështetur funksionimin e tyre dhe për të siguruar ofrimin e shërbimeve bazë.
- Të Ardhura të Tjera që mund të përfshijnë donacione, grante nga organizata ndërkombëtare, ose të ardhura nga pasuritë dhe asetet e bashkisë.

Shpenzimet janë fondet që bashkia përdor për të ofruar shërbime dhe për të investuar në komunitet. Shpenzimet kryesore përfshijnë:

- Shërbimet Publike ku përfshihen shpenzimet për arsim, shëndetësi, pastrim, ndriçim publik, mirëmbajtje rrugësh, etj.
- Investimet Kapitale që janë shpenzime për projekte të mëdha infrastrukturore, si ndërtimi i shkollave, rrugëve, parqeve, qendrave komunitare, etj.

1.3.2 Lidhja e strukturës së buxhetit me prioritetet e komunitetit dhe ndikimi në jetën e përditshme.

Struktura e buxhetit të një bashkie reflekton prioritetet dhe nevojat e komunitetit që ajo shërben. Për shembull, nëse një bashki vendos të rrisë investimet në arsim, kjo mund të çojë në përmirësimin e cilësisë së shkollave lokale, duke ofruar një mjedis më të mirë mësimor për të rinjtë. Në të kundërt, nëse fondet alokohen më shumë për infrastrukturë rrugore, mund të përmirësohet lëvizshmëria dhe transporti në zonë.

Është thelbësore që qytetarët, veçanërisht të rinjtë, të jenë të informuar dhe të angazhuar në procesin e buxhetimit. Pjesëmarrja aktive në konsultimet publike dhe shprehja e mendimeve mbi prioritetet e shpenzimeve mund të ndikojë drejtpërdrejt në vendimet që merren. Kjo siguron që fondet publike të përdoren në mënyrë që adreson nevojat reale të komunitetit, duke përmirësuar cilësinë e jetës për të gjithë.

Për shembull, një sondazh i realizuar në Bashkinë Shijak synonte të mblidhte mendimin e komunitetit mbi mënyrën sesi bashkia i ka shpenzuar paratë gjatë vitit 2020 dhe të kuptonte prioritetet e komunitetit në lidhje me buxhetin afatmesëm 2022-2024

Kjo tregon rëndësinë e përfshirjes së qytetarëve në procesin e buxhetimit për të siguruar që shpenzimet publike të reflektojnë nevojat dhe dëshirat e tyre.

Në përfundim, struktura e buxhetit të një bashkie është një pasqyrë e prioriteteve të saj dhe një mjet kyç për të adresuar nevojat e komunitetit. Përfshirja aktive e qytetarëve në këtë proces është thelbësore për të siguruar që vendimet financiare të jenë në përputhje me interesat e tyre dhe të kontribuojnë në përmirësimin e jetës së përditshme.

## 2 Procesi i Buxhetimit

### 2.1 Përfshirja e komunitetit dhe të rinjve në vendimmarrje

Pjesëmarrja e qytetarëve, veçanërisht të rinjve, në procesin e buxhetimit është një nga aspektet më të rëndësishme të një qeverisjeje transparente dhe demokratike. Kjo përfshirje garanton që zëri i komunitetit të dëgjohet dhe që nevojat dhe prioritetet reale të adresohen në mënyrë efektive.

2.1.1 Diskutimi i rëndësisë së përfshirjes së të rinjve në diskutimet publike për të përcaktuar prioritetet e komunitetit.

Përfshirja e të rinjve në diskutimet publike ka disa përfitime kryesore:

**Identifikimi i prioriteteve të ndryshme:** Të rinjtë shpesh kanë përvoja dhe këndvështrime të ndryshme që mund të ndihmojnë në ndërtimin e një plani buxhetor gjithëpërfshirës. Për shembull, ata mund të theksojnë rëndësinë e investimeve në arsimin teknologjik, hapësirat rinore, ose aktivitetet sportive.

**Nxitja e aktivizmit qytetar:** Pjesëmarrja në proceset e buxhetimit fuqizon të rinjtë, duke u dhënë një rol aktiv në formësimin e politikave dhe projekteve që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e tyre.

**Rritja e transparencës dhe llogaridhënies:** Kur të rinjtë marrin pjesë në konsultimet publike, ata bëhen më të ndërgjegjshëm për mënyrën se si shpërndahen fondet publike dhe kanë mundësi të kërkojnë llogari për përdorimin e tyre.

Në kontekstin shqiptar, shumica e bashkive organizojnë konsultime publike si një detyrim ligjor, por përfshirja e të rinjve shpesh është formale dhe jo efektive. Ky është një aspekt që kërkon përmirësim, duke u fokusuar në krijimin e mundësive më të mira për angazhimin aktiv të tyre.

#### 2.1.2 Shembuj mbi përfshirjen e qytetarëve në procesin e buxhetimit.

- **Buxhetimi me Pjesëmarrje në Brazil (Porto Alegre):** Qytetarët, përfshirë të rinjtë, janë përfshirë në mënyrë sistematike në vendimmarrje, duke diskutuar prioritetet dhe duke ndikuar direkt në alokimet e buxhetit. Ky model ka çuar në përmirësim të shërbimeve bazë, si arsimit dhe infrastruktura.
- **Këshilli Vendor Rinor (KVR)** në Lezhë përfaqëson një strukturë me potencial të lartë për të qenë zëri i të rinjve në proceset vendimmarrëse. Në praktikë, gjatë vitit 2023, aktivitetet e KVR-së janë përqendruar kryesisht në workshop-e, konkurse dhe aktivitete sociale, duke e anashkaluar rolin e tyre këshillues në politikat bashkiake. Raporti i publikuar për 2023 nuk tregon ndikim konkret në politikat lokale për rininë, çka ngre shqetësime për funksionimin efektiv të strukturës. Një nga faktorët kryesorë që ka penguar këtë rol është presioni i vazhdueshëm dhe ndikimi nga Bashkia dhe mungesa e hapësirës për veprim të pavarur. Pavarësia e KVR-së është minuar nga influence e forte e bashkisë për të rekrutuar të rinj që nuk ushtrojnë dot rolin Brenda një structure të paanshme advokimi rinor. Për më tepër, përfaqësimi i pabarabartë i anëtarëve (me dominim të nxënësve të shkollave të mesme) kanë kufizuar kapacitetin e këtij këshilli për të përmbushur mandatin e tij ligjor. KVR ka mundësinë të kthehet në një organ aktiv dhe efektiv që propozon rekomandime për:
  - Punësimin dhe aftësimin profesional të të rinjve;
  - Përmirësimin e infrastrukturës arsimore;
  - Ofrimin e më shumë shërbimeve sociale për të rinjtë.

Nëse struktura lihet të funksionojë pa presione dhe rekomandimet e saj merren seriozisht, KVR mund të sigurojë që prioritetet e të rinjve të reflektohen në buxhetin vjetor dhe planet strategjike të bashkisë. Kjo do të ishte një shembull

konkret i përfshirjes rinore në proceset e qeverisjes vendore dhe mbështetjes së transparencës dhe llogaridhënies.

## 2.2 Rëndësia dhe përfitimet e angazhimit komunitar në vendimmarrjen vendore

Angazhimi komunitar në proceset e vendimmarrjes është thelbësor për një qeverisje efektive dhe demokratike. Kur qytetarët, veçanërisht të rinjtë, përfshihen në diskutime dhe konsultime publike, krijohet një lidhje më e fortë mes komunitetit dhe institucioneve vendore, duke siguruar që politikat dhe buxheti të pasqyrojnë nevojat e vërteta të shoqërisë.

2.2.1 Përfitime si transparenca, ndarja më e drejtë e burimeve, dhe ndërtimi i besimit mes qeverisë dhe qytetarëve.

Kur procesi i buxhetimit është i hapur për pjesëmarrjen e komunitetit, vendimet bëhen më transparente. Publikimi i dokumenteve, mbajtja e takimeve publike dhe përfshirja e qytetarëve ndihmon në shmangien e abuzimeve dhe në rritjen e përgjegjësisë së institucioneve lokale. Për shembull, bashkitë që mbajnë takime konsultative për buxhetin mund të tregojnë qartë si dhe pse janë marrë vendimet për alokimin e fondeve.

Angazhimi i komunitetit garanton që burimet financiare të përdoren për projekte që adresojnë nevojat më të mëdha të qytetarëve. Të rinjtë mund të identifikojnë prioritete që shpesh anashkalohe, si hapësirat rinore, arsimimi teknologjik, mbështetja për aktivitetet kulturore dhe sportive. Kjo ndihmon që fondet të shpërndahen në mënyrë më të barabartë dhe të drejtë.

Kur qytetarët shohin që mendimet dhe rekomandimet e tyre merren seriozisht, rritet besimi i tyre ndaj institucioneve vendore. Ky besim përmirëson marrëdhëniet mes qeverisë dhe komunitetit dhe nxit angazhimin e vazhdueshëm të qytetarëve në vendimmarrje. Për shembull, nëse të rinjtë propozojnë projekte konkrete që reflektohen në buxhet, ata ndihen më të motivuar për të marrë pjesë edhe në të ardhmen.

2.2.2 Praktika për mbledhjen e mendimeve dhe nevojave të të rinjve.

Për të siguruar një përfshirje kuptimplotë të të rinjve në vendimmarrje, institucionet mund të zbatojnë praktika të ndryshme për mbledhjen e mendimeve dhe nevojave të tyre:

- **Konsultime Publike të Rregullta**

Organizimi i takimeve të hapura dhe forumeve me të rinjtë ku diskutohen prioritetet dhe projektet lokale. Këto konsultime duhet të jenë të strukturuar dhe të pasqyrojnë realisht shqetësimet e tyre. Për shembull, në Lezhë, gjatë hartimit të Planit Strategjik Vendor për Rininë 2024-2027, u mbajtën disa takime konsultative, por nuk përfshinë të gjitha rekomandimet e palëve të interesit.

- **Anketa dhe Platforma Digjitale**

Kryerja e anketave online dhe përdorimi i platformave digjitale për të mbledhur mendimet e të rinjve. Kjo është një metodë e shpejtë dhe efektive për të angazhuar sa më shumë pjesëmarrës. Bashkitë mund të përdorin aplikacione të thjeshta ku të rinjtë mund të votojnë për prioritetet kryesore në buxhet.

- **Fokus Grupe dhe Workshop-e (Punëtori)**

Organizimi i grupeve të fokusit me përfaqësues të ndryshëm të të rinjve, përfshirë nxënës, studentë dhe të rinj profesionistë. Këto grupe mund të japin rekomandime të detajuara për fusha të ndryshme, si arsimi, punësimi dhe shërbimet sociale.

- **Roli i Këshillit Vendor Rinor (KVR)**

KVR mund të jetë një strukturë kyçe për mbledhjen e nevojave dhe shqetësimeve të të rinjve dhe për përcjelljen e tyre në institucione. Megjithatë, siç është rasti në Lezhë, për funksionim të plotë, duhet të sigurohet pavarësia dhe mbështetja institucionale për këtë strukturë. Aktualisht, aktivitetet e KVR-së janë përqendruar më shumë në evente informale sesa në ushtrimin e rolit këshillues për politikat vendore.

## 2.3 Procesi i konsultimeve publike në hartimin e buxhetit

2.3.1 Çfarë janë konsultimet publike dhe si zhvillohen (bazuar në përvojën shqiptare dhe legjislacionin aktual).

Konsultimet publike janë një proces i strukturuar, ku qytetarët dhe grupet e interesit kanë mundësinë të shprehin mendimet dhe sugjerimet e tyre mbi projektet buxhetore dhe planet strategjike të njësisë të vetëqeverisjes vendore. Sipas

legjislacionit shqiptar, Ligji Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe Ligji Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" përcaktojnë detyrimin e bashkive për të përfshirë qytetarët në proceset e vendimmarrjes.

Në praktikë, bashkitë janë të detyruara të organizojnë konsultime të hapura me komunitetin, ku prezantohen projektbuxheti dhe prioritetet kryesore. Në rastin e Bashkisë Lezhë, procesi i konsultimit publik ka qenë një hap i rëndësishëm në hartimin e "Planit Strategjik Vendor për Rininë 2024-2027". Megjithatë, H.A.N.A. ka evidentuar mungesë të përfshirjes aktive të rinisë dhe të grupeve të tjera të interesit gjatë këtij procesi, duke theksuar nevojën për një qasje më gjithëpërfshirëse dhe transparente.

2.3.2 Rëndësia e pjesëmarrjes aktive të të rinjve në këto takime dhe teknikat për t'u përgatitur.

Pjesëmarrja aktive e të rinjve në konsultimet publike është thelbësore për të siguruar që nevojat dhe prioritetet e tyre të reflektohen në vendimet buxhetore të bashkisë. Nëpërmjet përfshirjes së tyre, rinia mund të ndikojë në projekte që lidhen me edukimin, hapësirat publike, aktivitetet kulturore dhe mundësitë për punësim.

Teknikat për përgatitjen e të rinjve për këto takime përfshijnë:

- **Njohuri mbi dokumentet buxhetore**

Rinia duhet të kuptojë strukturën e buxhetit dhe lidhjen e tij me prioritetet e komunitetit.

- **Përgatitja e argumenteve**

Përcaktimi i çështjeve më të rëndësishme dhe prezantimi i tyre në mënyrë të qartë dhe bindëse.

- **Praktika për të folur në publik**

Kjo ndihmon të rinjtë të fitojnë besim gjatë paraqitjes së ideve dhe rekomandimeve të tyre.

- **Përdorimi i shembujve konkretë**

Prezantimi i rasteve të suksesshme ku përfshirja rinore ka ndikuar pozitivisht në vendimmarrjen vendore.

Për më tepër, H.A.N.A. ka zhvilluar trajnime për të fuqizuar të rinjtë dhe për t'i pajisur ata me aftësi për të marrë pjesë në mënyrë efektive në këto konsultime.

Angazhimi i rinisë në proceset buxhetore është një hap drejt ndërtimit të një demokracie më gjithëpërfshirëse dhe llogaridhënëse.

### 3 Interpretimi i Dokumenteve Financiare

Interpretimi i dokumenteve financiare është një aftësi thelbësore për të rinjtë që duan të kuptojnë dhe ndikojnë në procesin e buxhetimit. Tabelat financiare përmbajnë të dhëna të rëndësishme për mënyrën se si një bashki mbledh dhe shpërndan burimet e saj, dhe të kuptuarit e këtyre elementeve mundëson pjesëmarrjen më të informuar dhe efektive në vendimmarrje.

#### 3.1 Si të lexohen dhe kuptohen tabelat financiare për buxhetin

3.1.1 Përmbledhje e elementeve kryesore si të ardhurat e përgjithshme, shpenzimet e detajuara dhe balanca financiare.

		2022	2023	2024	2025	2026	2027
1	Totali i shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave						
	Shpenzimet e përgjithshme / Të ardhurave të përgjithshme	88.9	89.5%	100%	100%	100%	100%
2	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore ndaj të ardhurave						
	Taksat dhe tarifat vendore / Të ardhurat e përgjithshme	26.4%	33.3%	52.0%	51.1%	50.7%	50.4%
3	Të ardhurat nga burimet e veta ndaj totalit të të ardhurave						
	Të ardhurat nga burimet e veta / Të ardhurat e përgjithshme	27.8%	34.1%	54.6%	53.6%	53.1%	52.9%
4	Shpenzimet kapitale ndaj totalit të shpenzimeve						
	Shpenzime kapitale / Shpenzimeve të përgjithshme	23.7%	26.8%	33.7%	34.8%	34.2%	34.4%
5	Shpenzime korrente ndaj shpenzimeve totale						
	Shpenzime korrente / Totali i shpenzimeve	33.9%	29.6%	30.2%	28.3%	28.3%	27.7%
6	Shpenzime për personelin ndaj totalit të shpenzimeve						

6

BASHKIA LEZHË

PBA 2025-2027

	Shpenzimet e personelit / Totali i shpenzimeve	42.4%	43.6%	36.1%	36.9%	37.5%	37.9%
7	Norma e huamarrjes afatgjatë ndaj totalit të të ardhurave						
	Huamarrja / Totali i të ardhurave	0.85%	0.56%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
8	Norma e huamarrjes afatgjatë ndaj të ardhurave të veta						
	Huamarrja / Totali i të ardhurave të veta	2.52%	1.41%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
9	Detyrimet e prapambetura ndaj totalit të të ardhurave gjithsej						
		21.0%	5.5%	4.2%	0.0%	0.0%	0.0%
10	Shpenzimet për politikat sociale ndaj totalit të shpenzimeve						
		4.9%	4.4%	4.4%	14.8%	5.7%	5.7%
11	Shpenzime që mbështesin barazinë gjinore/totalit të shpenzimeve						
		48.9%	48.8%	48.5%	48.4%	48.4%	48.4%

### Marrë nga PBA 2025-2027 – Bashkia Lezhë

Të ardhurat e përgjithshme - Pjesa e të ardhurave që bashkia mbledh, përfshirë taksa vendore, tarifa dhe të ardhura nga burimet e veta. Nga tabela, vihet re se të ardhurat nga burimet e veta arrijnë në 52.9% në 2027, nga 27.8% në 2022, duke treguar rritje të mbledhjes së brendshme të fondeve.

Shpenzimet totale - Shpenzimet përfshijnë kapitale (investime) dhe korente (shpenzime të përditshme). Shpenzimet kapitale janë rritur nga 23.7% në 2022 në 34.4% në 2027, duke treguar prioritet në investime.

Shpenzimet për personelin - Ulja nga 42.4% në 2022 në 37.9% në 2027 tregon një përpjekje për të optimizuar shpenzimet për administratën.

Huamarrja - Norma e huamarrjes afatgjatë është 0.85% në 2022 dhe shkon në 0% nga 2024-2027, tregues i qëndrueshmërisë financiare të bashkisë.

### 3.1.2 Ushtrime praktike me shembuj realë të dokumenteve buxhetore.

<b>PRIORITETET E INVESTIMEVE DHE BURIMET E FINANCIMIT PËR VITET 2025-2027</b>					
IDENTIFIKIMI I PROJEKTEVE KAPITALE	BURIMI I FINANCIMIT (I MUNDSHËM)	VLERA 000/lekë	PËRIUDHA E FINANCIMIT		
			2025	2026	2027
Ndërtimi i Zyrës Info Point në Lezhë	Bashkia Lezhë	4,000			4,000
Ndërtimi Tregut Gjësë Gjallë Lezhë	Bashkia Lezhë	26,950		26,950	
Ndërtimi Tregut Lëvizës Shëngjin	Bashkia Lezhë	20,000		20,000	
Ndërtimi Tregut Lëvizës Tale	Bashkia Lezhë	20,000			20,000
Rikonstruksion i Kanaleve Ujitës Sv 14,15,18	Bashkia Lezhë	75,820			75,820
Ndërtimi i Qëndres të qeneve endacakë	Bashkia Lezhë	50,000		50,000	
Mbarështimi i fondit pyjor dhe kullosor	Bashkia Lezhë	29,000		15,000	14,000
Zbatimi i Projektit Turizmit Malor Ungrej	Bashkia Lezhë	57,592		57,592	
Kompozim/vendosje e Shtatores Skenderbeut	Bashkia Lezhë	10,000		10,000	
Ndërtimi Terminalit Autobuzave Shëngjin	Bashkia Lezhë	161,854	161,854		

8

#### BASHKIA LEZHË

PBA 2025-2027

Ndërtimi i Parkimit Mjeteve Lezhë	Bashkia Lezhë	95,838	95,838		
Rehabilitim i rrugëve rurale	Bashkia Lezhë	288,322	37,841	110,481	140,000
Rehabilitim i rrugëve urbane	Bashkia Lezhë	515,972	17,844	289,128	209,000
Hartimi i Planit Studimor për përmbytjet	Bashkia Lezhë	10,000		10,000	
Ndërtimi i Stacionit Zjarrfikës Shëngjin	Bashkia Lezhë	30,000		30,000	
Ndërtimi i Stacionit Zjarrfikës Lezhë	Bashkia Lezhë	80,000			80,000
Ndërtimi i Pritave Malore në zonat pyjore	Bashkia Lezhë	30,000		15,000	15,000
Pyllëzim të sipërfaqeve pyjore	Bashkia Lezhë	7,065		2,065	5,000
Ndërtim i Parkut Lojrave me Dorë	Bashkia Lezhë	25,576	25,576		
Rikonstruksion objektsh të Arsimit Bazë	Bashkia Lezhë	109,260	85,260		24,000
Rikonstruksion objektsh të Arsimit Mesëm	Bashkia Lezhë	50,000	25,000		25,000
Ndërtimi Qëndres Zhvillimit Ditor Lezhë	Bashkia Lezhë	200,000	200,000		
Ndërtimi Qëndres Rezidentale të moshës tretë	Bashkia Lezhë	23,000		23,000	
Ndërtimi Qëndres Multifunkionale Shënkoll	Bashkia Lezhë	20,000			20,000
<b>TOTALI</b>		<b>1,940,249</b>	<b>542,212</b>	<b>672,213</b>	<b>619,151</b>

#### Shembull nga tabela më lart:

Identifikimi i Projekteve Kapitale	Vlera (000/lekë)	Periudha
Ndërtimi i Tregut Lëvizës Tale	20,000	2025

Identifikimi i Projekteve Kapitale	Vlera (000/lekë)	Periudha
Rikonstruksioni i Kanaleve të Ujitjes SV 14,15,18	75,820	2025
Zbatimi i Projektit Turizmi Malor Ungrej	57,592	2025
Ndërtimi i Terminalit të Autobuzave Shëngjin	161,854	2025

### Interpretim:

- Bashkia ka prioritet për projekte madhore si **rikonstruksioni i kanaleve** dhe **ndërtimi i terminalit të autobusave**, që kanë vlera të mëdha për infrastrukturën.
- Përfitimet janë të drejtpërdrejta për komunitetin, duke përmirësuar **transportin dhe bujqësinë**.

---

### Shembull i Shpenzimeve për Politikën Sociale:

Viti	Pjesa në % e Shpenzimeve Totale
2022	4.9%
2025	14.8%
2027	5.7%

### Interpretim:

- Në 2025, shpenzimet për politikën sociale rriten në **14.8%**, duke reflektuar një fokus të përkohshëm për mbështetje sociale.

### Ushtrim Praktik:

- Identifikoni tabelën e shpenzimeve dhe tregoni se cilat sektorë kanë më shumë përfitim midis **investimeve në arsim, kulturë apo transport**. Analizoni tendencën nga viti 2022-2027.

## 3.2 Identifikimi i shpenzimeve prioritare dhe objektivave të politikave

### 3.2.1 Si të dallohen shpenzimet që ndikojnë drejtpërdrejt në prioritetet e komunitetit.

Shpenzimet prioritare janë ato që mbështesin nevojat më të rëndësishme të komunitetit dhe përputhen me objektivat e politikave vendore, si përmirësimi i infrastrukturës, arsimit, shërbimet sociale dhe mundësitë për të rinjtë. Për t'i dalluar këto shpenzime, është e rëndësishme të ndiqen disa hapa kryesorë:

1. Analiza e dokumenteve financiare – Duke shqyrtuar raportet buxhetore si ai i PBA 2025-2027 për Bashkinë e Lezhës, mund të identifikohen shpenzimet që lidhen me sektorët më të rëndësishëm për komunitetin (p.sh., arsimit, rinia, kultura, infrastruktura).
2. Konsultimi me komunitetin – Prioritetet e komunitetit mund të kuptohen përmes mbledhjes së mendimeve dhe konsultimeve me qytetarët, veçanërisht me të rinjtë.
3. Analiza e ndikimit – Vlerësimi nëse shpenzimet e planifikuara do të sjellin një përmirësim të prekshëm në cilësinë e jetës së komunitetit (p.sh., krijimi i hapësirave rinore apo përmirësimi i aksesit në arsim dhe sport).
4. Përafrimi me politikat ekzistuese – Kontrolloni nëse shpenzimet janë në përputhje me dokumente strategjike, si Plani Strategjik Vendor për Rininë 2024-2027, që përcakton prioritetet për të rinjtë në Lezhë.

*Shembull konkret nga dokumenti I PBA 25-27, Bashkia Lezhë*

- Në tabelën e investimeve kapitale të Bashkisë Lezhë, prioritet i dukshëm është rikonstrukcioni i kanaleve të ujitjes, ndërtimi i tregjeve lëvizëse dhe terminaleve të transportit, por mungon një fokus i dukshëm për projekte rinore dhe sportive.
- Për shembull, investimet për projekte rinore specifike nuk paraqiten si kategori prioritare në të njëjtën shkallë si infrastruktura kapitale.

### 3.2.2 Shembull: përzgjedhja e fondeve për projekte rinore dhe sportive.

Për të analizuar më mirë këtë çështje, le të shohim një krahasim nga investimet kapitale të Bashkisë Lezhë:

<b>Identifikimi i Projekteve Kapitale</b>	<b>Vlera (000/lekë)</b>	<b>Periudha e Financimit</b>
<b>Ndërtimi i Parkut Lojërave në Dorë</b>	25,576	2025
<b>Ndërtimi i Qendrës Zhvillimit Ditor Lezhë</b>	200,000	2025

- **Parku i Lojërave në Dorë** është një shembull pozitiv që kontribuon në krijimin e hapësirave rinore për argëtim dhe aktivitete fizike. Ky projekt, me vlerë relativisht të ulët (25,576,000 lekë), ka ndikim të drejtpërdrejtë në komunitet, veçanërisht për të rinjtë.
- **Qendra e Zhvillimit Ditor** përfaqëson një investim madhor që mbështet **shërbimet sociale**, duke adresuar nevojat e fëmijëve dhe grupeve të cenueshme.

#### **Reflektim:**

- Edhe pse disa projekte me fokus social dhe rinor janë të pranishme, pjesa më e madhe e buxhetit shkon për **infrastrukturën kapitale** (p.sh., rehabilitimi i rrugëve, terminali i autobusëve, stacionet zjarrfikëse).
- Nevojitet një **ribalancim i prioriteteve**, ku projekte të vogla dhe me ndikim të lartë për të rinjtë, si ndërtimi i **qendrave sportive**, hapësirave komunitare dhe mbështetja për aktivitete kulturore, të marrin më shumë vëmendje në buxhetin e bashkisë.

Të rinjtë duhet të angazhohen për të kërkuar më shumë **fonde për projekte rinore** dhe sportive përmes pjesëmarrjes në konsultimet publike. Për shembull, në takimet e radhës për buxhetin e Bashkisë Lezhë, Këshilli Vendor Rinor (KVR) dhe organizatat rinore mund të propozojnë:

- Rritje të investimeve për **qendra sportive dhe kulturore**.
- Projekte për **aktivitete edukative** që përfshijnë teknologjinë dhe aftësimin profesional.
- Krijimin e **hapësirave të gjelbra dhe qendrave rinore** për mbështetje sociale dhe zhvillim të aftësive të të rinjve.

Kjo qasje do të ndihmojë që buxheti të reflektojë realisht prioritetet dhe nevojat e komunitetit rinor.

## 4 Zhvillimi i Aftësive Praktike

### 4.1 Ushtrime në interpretimin e dokumenteve të buxhetit

Interpretimi i dokumenteve të buxhetit mund të duket i ndërlikuar në fillim, por përmes ushtrimeve praktike dhe përdorimit të vizualizimeve të thjeshta, pjesëmarrësit mund të mësojnë të analizojnë dhe kuptojnë informacione të rëndësishme financiare. Kjo aftësi është thelbësore për të rinjtë që duan të marrin pjesë aktive në monitorimin e buxhetit dhe vendimmarrjen vendore.

4.1.1 Ushtrime të thjeshta që i ndihmojnë pjesëmarrësit të kuptojnë dhe analizojnë dokumentet financiare.

Ushtrimi I: Leximi i Tabelave të të Ardhurave dhe Shpenzimeve  
Objektivi: Të kuptohen të ardhurat, shpenzimet dhe balanca financiare.

Shembull praktik:

Nga tabela e PBA 2025-2027 për Bashkinë Lezhë:

Viti	Të Ardhura nga Burimet e Veta (%)	Shpenzime Kapitale (%)	Shpenzime Korrente (%)
2022	27.8%	23.7%	33.9%
2025	53.6%	34.8%	28.3%
2027	52.9%	34.4%	27.7%

Pyetje për analizë:

I. Si kanë ndryshuar të ardhurat nga burimet e veta midis 2022 dhe 2027?

2. A është rritur përqindja e shpenzimeve kapitale? Pse kjo mund të jetë e rëndësishme për zhvillimin e komunitetit?
3. Cili është ndikimi i uljes së shpenzimeve korrente në vitet në vijim?

## Ushtrimi 2: Identifikimi i Prioriteteve të Investimeve

Objektivi: Të kuptohet se cilat projekte janë prioritet për bashkinë dhe si financohen.

Shembull praktik nga prioritetet e investimeve të PBA 2025-2027:

Projekti	Vlera (000/lekë)	Periudha
Ndërtimi i Terminalit Autobuzave Shëngjin	161,854	2025
Rikonstruksioni i Kanaleve Ujitëse	75,820	2025
Ndërtimi i Qendrës Zhvillimit Ditor Lezhë	200,000	2025
Ndërtimi i Parkut Lojërave në Dorë	25,576	2025

Pyetje për analizë:

1. Cilat projekte janë më të kushtueshme dhe cilat janë më të përballueshme?
2. A përfshijnë këto investime prioritetet e komunitetit, veçanërisht të rinjve?
3. Cili është ndikimi i ndërtimit të Terminalit Autobuzave në përmirësimin e transportit publik?

4.1.2 Përfshirja e tabelave dhe grafikëve vizualë për ta bërë më të lehtë procesin.

Përdorimi i **grafikëve dhe vizualizimeve** e bën interpretimin e të dhënave financiare më të lehtë dhe më të kuptueshëm për pjesëmarrësit. Këtu janë disa teknika që mund të përdoren:

- ✚ **Grafiku rrethor (pie chart):** Përdoret për të paraqitur ndarjen e shpenzimeve sipas kategorive (p.sh., shpenzime kapitale vs. korrente).  
**Shembull:**

- 34.8% për shpenzime kapitale.
  - 28.3% për shpenzime korrente.
- ✚ **Grafiku i kolonave (bar chart):** Përdoret për të treguar ndryshimin e të ardhurave dhe shpenzimeve ndër vite.
- Shembull:** Krahasimi i rritjes së të ardhurave nga burimet e veta në 2022, 2025 dhe 2027.
- ✚ **Tabelat përmbledhëse:** Thjeshtësojnë informacionet komplekse në formë të qartë dhe të organizuar për të analizuar përparësitë e financimit dhe nevojat e komunitetit.

## 4.2 Rast studimor

4.2.1 Një rast konkret nga një bashki shqiptare ku të rinjtë kanë ndikuar në ndarjen e fondeve për një projekt të veçantë (p.sh., ndërtimi i një këndi për të rinjtë).

Një shembull konkret i angazhimit të të rinjve në procesin e ndarjes së fondeve për projekte rinore vjen nga Bashkia e Beratit. Në vitin 2022, Këshilli Rinor i qytetit u përfshi për herë të parë në diskutimet mbi buxhetin e bashkisë. Kjo iniciativë, e mbështetur nga shoqëria civile dhe kryebashkiaku Ervin Demo, synonte të siguronte që zëri i të rinjve të dëgjohej në vendimmarrjet financiare që prekin komunitetin e tyre.

Përfshirja e Këshillit Rinor në këto diskutime rezultoi në identifikimin dhe mbështetjen e projekteve që adresonin nevojat dhe interesat e të rinjve në Berat. Kjo qasje jo vetëm që fuqizoi të rinjtë, por gjithashtu siguroi që fondet publike të përdoren në mënyrë më efektive për të përmirësuar jetën e komunitetit rinor.

Ky rast tregon rëndësinë e përfshirjes aktive të të rinjve në proceset vendimmarrëse lokale dhe demonstroi se si angazhimi i tyre mund të ndikojë pozitivisht në alokimin e fondeve për projekte që i shërbejnë drejtpërdrejt komunitetit.

## **Përmbyllje**

Dokumenti qëndron si një mjet i rëndësishëm për fuqizimin e të rinjve dhe aktorëve të komunitetit për të kuptuar dhe ndikuar në proceset buxhetore të njësisë të vetëqeverisjes vendore. Përmes moduleve dhe përmbajtjes së ofruar, synohet jo vetëm rritja e transparencës dhe llogaridhënies në qeverisjen lokale, por edhe përfshirja më aktive dhe kuptimplotë e të rinjve në vendimmarrje.

Si pjesë e implementimit të ndërhyrjes "Itinerari i Parasë Publike - Rinia Raporton", mbështetur nga mekanizmi BAT (Budget Accountability and Transparency) dhe financuar nga Bashkimi Evropian, ky dokument është dëshmi e përkushtimit të H.A.N.A. për të promovuar demokracinë, pjesëmarrjen qytetare dhe fuqizimin e zërit rinor. Ndërkohë që në terren ka ende sfida për të kapërcyer, ky material është një hap drejt edukimit të rinisë dhe aktivizimit të tyre për ndryshim real.

Në fund, të rinjtë janë katalizatorët e ndryshimit në çdo komunitet. Fuqizimi i tyre për të lexuar, kuptuar dhe ndikuar në proceset buxhetore është jetik për të ndërtuar një qeverisje të përgjegjshme dhe të përqendruar te nevojat reale të qytetarëve. H.A.N.A. mbetet e përkushtuar për të vazhduar këtë rrugëtim dhe për të ndërtuar një bashkëpunim të qëndrueshëm mes të rinjve, komunitetit dhe institucioneve lokale.

*Shtator 2024*

